

A young child with short brown hair, wearing pink shorts, stands in shallow, rippling water. The child is holding a dark, round object in their hands. The background is a bright, sunny outdoor setting with water reflecting light. A semi-transparent white rectangular area is overlaid on the right side of the image, containing text.

Wilhelm Busch

**PSE  
JETOJ?**

MEOS Svizzera



Wilhelm Busch

**Pse jetoj?**

Marrë nga libri „Jesus unser Schicksal“

Titulli i originalit: “Wozu lebe ich?”

© Aussaat-Verlag Neukirchen-Vluyn

© për botimin në gjuhën shqipe: MEOS Svizzera  
Literaturdienst Zum Guten Brunnen,  
Hirzenbachstrasse 102, Postfach 1, CH-8061 Zürich

Në bashkpunim me:

EAD, Postfach 30 02 64, D-44232 Dortmund

Verbreitung Christlicher Schriften  
Postfach, CH-2500 Biel/Bienne 8

Përktheu: Tom Pergjokaj

Realizimi kompjuterik: Gjevalin Kabashi

Botimi i parë 2000

Shtypur në Zvicer: Good News Druck, Höri ZH

## PSE JETOJ?

Gjithçka sillet rreth pyetjes: Pse jetoj? ose: Çfarë kuptimi ka jeta?

Një ditë në Essen më telefonoi një industrialist i pasur. Ishte shumë i shqetësuar. «Z. pastor, ejani menjëherë!» Shkova shpejt dhe kur arrita, më tha: «Djali im ka vrrarë veten!» Unë e njihja këtë të ri. Ishte student. Ai kishte gjithçka që i donte zemra. Ishte i shëndoshë, i hijshëm, i ri dhe i pasur. Kishte një kohë të gjatë që kishte veturën e vet dhe nuk përzihej në punë të dyshimta. Dhe ky i ri kishte qëlluar veten plumb në kokë! Kishte lënë një letër me këto fjalë: «Nuk e shoh të arsyeshme të jetoj më gjatë. Jeta ime nuk ka kuptim. Prandaj po i jap fund». Tronditëse!

Pyetja se ç'kuptim ka jeta është shumë e rëndësishme. Kjo pyetje ka një rëndësi kaq të madhe sepse kemi vetëm një jetë për të jetuar. A keni menduar ndonjëherë se ç'do të thotë të kesh vetëm një jetë?

Kur kam qenë nxënës, nuk kam qenë shumë i mirë në matematikë. Mësuesi im nuk e kuptonte se si vija deri të zgjidhja e problemit. Kur i bëja detyrat e shtëpisë, ai nganjëherë i binte fletorës vija me laps të kuq për të treguar se sa pak e çmonte talentin tim për gjetjen e rezultateve të gabuara. Kur më mbushej fletorja me vija të kuqe, unë e hidhja atë, nganjëherë e hidhja ende pa u mbushur plot vetëm për të blerë një të re, të pastër. Kështu mund të filloja edhe një herë nga fillimi.

Do të ishte gjë e mrekullueshme po të mund të bënim kështu edhe me jetën tonë! Më besoni se miliona njerëz në pragun e vdekjes, mendojnë: «Ah, sikur të mund të jetoja edhe një herë nga fillimi! Do të kisha jetuar krejtësisht ndryshe!»

Është gjë e lehtë të blesh një fletore të re dhe t'ia nisësh edhe një herë prej fillimit, por kjo nuk është e mundshme me jetën! Kemi

vetëm një jetë. Sa tmerr është kur e prishim jetën duke mos jetuar si duhet. Kemi vetëm një jetë të vetme. Nëse e humbim këtë jetë, e kemi humbur përgjithmonë. Merrne seriozisht këtë që po ju them. Fjala është për jetën dhe për vdekjen!

Sot në mëngjes një kope lopësh kaloi pranë hotelit ku po qëndroj. Mendova: «Sa fatlume që janë lopët. Ato nuk kanë nevojë të mendojnë pse janë në këtë botë. Është gjë e qartë: ato duhet t'u japin qumësht njerëzve dhe nëse nuk japin qumësht, atëherë japin mish». A më kuptoni se ç'dua të them? Kafsha nuk ka nevojë të mendojë për kuptimin e jetës. Ky është dallimi ndërmjet njeriut dhe kafshës. Mjerisht ka shumë njerëz që jetojnë dhe vdesin pa pyetur veten: «Cili është qëllimi i vërtetë i jetës sime?» Të tillët nuk dallohen nga kafshët. Njeriu dallohet nga kafsha kur e gjen kuptimin e jetës. Kuptimin e jetës e gjen kur fillon të pyesë veten: «Pse jam në këtë botë? Pse jam njeri? Pse jetoj?»

## 1. PËRGJIGJET E SIPËRFAQSHME DHE TË PAMENDUARA

Miq të dashur, ka shumë përgjigje të sipërfaqshme dhe të pamenduara rreth pyetjes: «Pse jetoj?» Para shumë vjetësh kam patur rastin të dëgjoj përgjigje të tilla. Ishte viti 1936, koha e Rajhut të Tretë. Disa studentë nga qyteti Münster m'u lutën të flasë me ta lidhur me temën: «Cili është kuptimi i jetës sime?» Më thanë hapur se nuk dëshironin të dëgjonin predikim, por vetëm donin të diskutonin rreth kësaj teme. «Mirë», u thashë, atëherë t'ia fillojmë! Ç'kuptim ka jeta? Pse jetoj?»

Meqenëse nazistët ishin në pushtet në atë kohë kur u mbajt ky takim, ishte e natyrshme që një student u ngrit dhe tha: «Unë jetoj për popullin tim. Kjo është si pema e gjethi. Gjethi nuk është asgjë, pema është gjithçka. Unë jetoj për popullin tim». - «Mirë», iu përgjigja, «pse ekziston pema, pse ekziston populli? Mbretëroi heshtja! Këtë nuk e dinte. Nuk kishte përgjigje për këtë pyetje. Thjesht e la anash. Pastaj u thashë: «Miq të dashur, ju po u shmangeni përgjigjes me pyetje të tilla!»



«Çfarë kuptimi ka jeta? Pse jetojmë?» pyeta përsëri. Një tjetër u përgjigj: «Unë jetoj për të kryer detyrën time». Atij i thashë: «Kjo është e gjithë çështja. Cila është detyra ime? Unë mendoj se detyra ime është që juve t'ju predikoj Fjalën e Zotit. Mathilda Ludendorff mendon se detyra e saj është të mohojë ekzistencën e Perëndisë. Pra, cila është detyra?»

Një zyrtar i lartë shtetëror njëherë më tha: «Z. pastor, le të mbetet kjo vetëm mes nesh. Nga mëngjesi deri në mbrëmje nënshkruaj dokumente, por edhe nëse të gjitha ato digjen, bota vazhdon të ekzistojë. Më vjen keq që kam harxhuar kohë dhe energji për një punë kaq të pakuptim». - Atëherë cila qenka detyra?

Gjatë Rajhut të Tretë, mijëra anëtarë të njësive SS kanë vlarë qindra e mijëra njerëz. Dhe kur më vonë dolën para gjyqit, ata mbroheshin duke thënë: «Ne vetëm kemi kryer detyrën tonë. Kemi qenë të urdhëruar». A e besoni së është detyrë e njeriut të vrasë njerëz? Unë nuk mund ta besoj këtë.

Pastaj u thashë studentëve: «Këtu qëndron thelbi i problemit. Ç'është detyra? Kush mund të më tregojë? Duket se përsëri jemi në fillim!

Të rinjtë dukeshin të kredhur në mendime. Pastaj njëri u ngrit dhe me krenari tha: «Unë rrjedh nga një familje e vjetër aristokrate. Mund t'i numëroj 16 brezat e kaluar. Kjo është një gjenealogji e madhe! A nuk është përpjekja për të vazhduar brezin e ri detyrë mjaft e rëndësishme e jetës për shkak të së cilës ia vlen të jetohet? Menjëherë iu përgjigja: «Më vjen keq, por në qoftë se nuk dihet pse kanë jetuar brezat e mëparshëm, atëherë nuk ia vlen të krijojmë një brez të ri!»

Ka shumë përgjigje të tilla të sipërfaqshme dhe të pamenduara. Nëpër gazeta shpesh lexojmë lajmërimë vdekjelesh si ky:

«Jeta jote ishte vetëm punë, kurrë nuk ke menduar për vete. Je munduar për familjen tënde, kjo ishte për ty detyrë mbi detyra».

Këto fjalë më zemërojnë tepër dhe më bëjnë të mendoj: «Kjo është një nekrologji për kuaj!» A nuk është ashtu? Kali nuk bën gjë tjetër përveç punës. Nuk besoj se njeriu është në këtë botë vetëm për të punuar. Ky do të ishte një mjerim. Po të ishte qëllimi i jetës sonë: «Jeta jote ishte

vetëm punë...», atëherë do të ishte më mirë të bënim vetëvrasje që në moshën 10 vjeçare. Kjo është gjë e tmerrshme! Jo, ky nuk mund të jetë qëllimi i jetës sonë.

Një student tjetër në vazhdim të bisedës më tha: «Shikoni, unë do të bëhem mjek. Dhe nëse mund t'ua shpëtojë jetën njerëzve, a nuk është kjo arsye e mirë për të jetuar?» - «Mirë», i thashë, «por nëse nuk e dini pse jeton njeriu, atëherë është e pakuptim t'ia shpëtoni jetën. Do të ishte më mirë t'i jepnit një gjilpërë që të vdiste menjëherë». Ju lutem, mos më keqkuptoni. Nuk thashë se duhet t'u japim njerëzve gjilpëra vdekjeprurëse. Por, dua të them se përgjigjja e studentit të mjekësisë nuk është zgjidhja e çështjes së kuptimit të jetës.

I rrethuar nga të gjithë ata studentë, u trontida kur e pashë se edhe njerëzit e arsimuar të ditëve tona jetojnë në këtë botë duke mos e ditur pse. Ndoshta edhe ju do të zemëroheni, ashtu si ata, për shkak të mënyrës se si po flas. Natyrisht, mund të përdor një gjuhë më të lëmuar me fjalë të huaja, por mbas një gjysmë ore do t'ju kishte zënë gjumi. Mirëpo, meqenëse i frikësohem tmerrësisht kësaj, do të vazhdoj të

flas ashtu si flasin njerëzit njëri me tjetrin. Qartë? Faleminderit!

E shihni, pasi të kaloni nëpër të gjitha ato që kemi kaluar ne në Gjermani, nuk është çudi që edhe ju t'i merrni të njëjtat përgjigje që mora unë nga studentët në Münster: «Jeta nuk ka aspak kuptim të thellë. Është krejtësisht një rastësi që unë kam lindur. Çfarë kuptimi mund të ketë? Të kënaqemi me jetën sa të mundemi».

Ndoshta ky është tundimi më i madh përmes të cilit duhet të kalojë çdo njeri që fillon të mendojë për kuptimin e jetës: «Jeta ime është absurde. Po të mos ishin martuar prindërit e mi, unë nuk do të isha ngjizur as nuk do të kisha lindur. Është krejt rastësi që ekzistoj. Në realitet, jeta ime është krejtësisht e pakuptim». Dhe nëse një njeri i tillë ballafaqohet me vështirësi në jetë, ai është shumë afër vetëvrasjes. «Pse të jetoj kur gjithçka është rastësi dhe pakuptim? Më mirë t'i jap fund jetës!» A e dini se në Gjermaninë Perëndimore numri i njerëzve që bëjnë vetëvrasje është më i madh se i atyre që humbin jetën në fatkeqësi komunikacioni? A e dini se 50 për qind të vetëvrasësve janë të rinj nën 30 vjeç?

Kjo është një dëshmi tronditëse e kohës sonë:  
nuk e shohim më kuptimin e jetës!

Shpesh kam biseduar me njerëz, të cilët thonë: «Jeta nuk ka kurrfarë kuptimi. Ose do të kënaqem me të, ose do t'i jap fund me vetëvrasje». Unë i pyesja: «P or ç'thoni nëse ka kuptim? Nëse me të vërtetë ka kuptim dhe ju jetoni sikur të mos kishte kuptim? Ç'do të ndodh me ju në fund të jetës suaj?»

Në Bibël është një varg që duhet të na mbush me frikë: «Njerëzve u duhet një herë të vdesin e pastaj vjen gjyqi». Njeriu duhet ta dijë këtë të vërtetë biblike që të mundë të pyetë seriozisht: «Pse jetoj?» Nuk mund të vdes dhe të dal para Gjyqit të Perëndisë nëse nuk e kam gjetur kuptimin e jetës. A e keni tani pyetjen të qartë? Atëherë të shkojmë një hap më tutje.

## **2. KUSH MUND TË NA JAPË PËRGJIGJE?**

Kush mund të na japë përgjigje në pyetjen: «Pse jetoj?» - Kush? Kisha? Jo. Prifti? Jo. Ai është në të njëjtën gjendje si ne. Shkencëtarët? Filozofët? As ata nuk mund të japin përgjigje në

pyetjen: «Pse jetoj?» Vetëm njëri mund të na tregojë. Ai është Krijuesi ynë - Zoti.

Do të përdor një ilustrim qesharak. Ta zëmë se një ditë hyj në një banesë dhe gjej një djalë ulur duke bërë diçka me disa tela dhe me një llambë. E pyes: «Më thuani, ç'aparaturë djallëzore po bëni? Ç'do të përftoni në fund?» Ai më sqaron, por unë duhet ta pranoj se nuk kuptoj asgjë. Mendoj me vete: «Askush nuk mund ta kuptojë se çfarë shpikje do të jetë. Vetëm shpikësi mund ta dijë se ç'do të jetë dhe për se do të shërbejë».

Ashtu është edhe me jetën tonë. Vetëm ai që na ka krijuar mund të tregojë pse na ka krijuar. Kjo do të thotë se përgjigjen e pyetjes: «Pse jetoj?» mund ta marrim vetëm përmes zbulimit - Zoti duhet të na tregojë! Po të mos isha lexues i zellshëm i Biblës, atëherë vetë kjo pyetje do të më kishte shtyrë ta lexoj. Nuk do të kisha duruar pa e ditur pse jam në këtë botë të mallkuar. A ju duket shprehja «botë e mallkuar» e tepruar? Kjo është në Bibël. Po të kishit qëndruar gjashtë muaj me një pastor në një qytet të madh, do ta kishit ditur se ç'dua të them kur pohoj se kjo botë është nën mallkim të tmerrshëm. Nuk do të

kisha duruar të jetoja në këtë botë po të mos kisha marrë përgjigje përmes zbulesës së Zotit.

Zoti na përgjigjet në Bibël për sa i përket kuptimit të jetës. Kjo është arsyeja pse Bibla është kaq e rëndësishme. Njoh njerëz, të cilët me kokën lart thonë: «Ne nuk e lexojmë Biblën!» Atyre mund t'iu them vetëm këtë: «Atëherë jam i sigurt se ju asnjëherë nuk keni menduar seriozisht rreth pyetjes 'Pse jetoj?''' Por marrëzia është një sëmundje shumë e përhapur dhe po të shkaktonte dhimbje, bota do të mbushej me ofshama. Po ju jap përgjigjen e Biblës me një fjali: Zoti na ka krijuar që ne të jemi fëmijët e tij!

Ashtu si një prind që ka dëshirë të shohë veten në fëmijën e vet, ashtu Zoti krijoi njeriun «sipas shëmbëlltyrës dhe përngjasimit të vet». Zoti don që ne të bëhemi fëmijët e tij, fëmijë të cilët flasim me të dhe me të cilët ai mund të flasë; fëmijë të cilët e duan atë dhe të cilët ai i do. A luteni ndonjëherë? Sa gjë e hidhur është për një prind nëse fëmija i tij nuk flet me të me vite të tëra. Kështu, nëse njeriu nuk lutet, ai nuk flet me Atin e tij qiellor. Pra, Zoti dëshiron që ne të jemi fëmijë të tij, të cilët flasim me të dhe e

duan atë. Ky është kuptimi i ekzistencës sonë. Nuk po flas për kishën, për doktrinën, apo për fenë. Po flas për Zotin e gjallë. Zoti ju ka krijuar që të mund të bëheni fëmijë i tij. A jeni fëmijë i tij?

Të bëjmë një hap më tutje. Ne duhet të jemi fëmijë të Zotit, por për nga natyra nuk jemi. Në fillim të Biblës thuhet: «Zoti krijoi njeriun sipas përngjasimit të vet». Pastaj Bibla tregon për një katastrofë të madhe. Njeriu ishte krijuar si një qenie me liri të plotë dhe si i tillë vendosi të jetë kundër Zotit. Ai hëngri nga pema e ndaluar. Kjo do të thoshte: «Dua të jem i pavarur! Mund të jetoj edhe pa Zotin!» E kuptoni? Adami nuk ka dyshuar asnjëherë për ekzistencën e Zotit, por vetëm është larguar prej tij: «Do të jetoj ashtu si dua vetë!»

Pak kohë më parë një njeri, të cilin e takova në rrugë, më tha: «Ju flisni gjithnjë për Zotin. Por unë nuk e shoh. Më tregoni si mund ta gjej Zotin». Unë iu përgjigja: «Dëgjoni me kujdes! Përfytyrojeni se ekziston një makinë që do të mund të më kthente mbrapa në kohë. Ta zëmë se me të mund të shkoj në fillim të historisë së njerëzimit dhe një mbrëmje shëtis nëpër



kopshtin e Edenit. Sigurisht e dini ngjarjen se si njeriu ka rënë në mëkat? Aty te një kaçube e takoj Adamin, njeriun e parë. «Mirëmbërëma, Adam!» e përshëndes. «Mirëmbërëma, pastor Busch!» ma kthen ai. «Befasohesh që më sheh?» e pyes dhe i tregoj se si kam mbërritur në kopshtin e Edenit. «Dukesh si në kujtim», thotë Adami dhe shton: «Ç'të mundon?» I përgjigjem: «Po mendoja për një pyetje që ma ka bërë njëri: Si mund ta gjej Zotin?» Adami qesh me të madhe dhe më thotë: «Nuk është kurrfarë problemi si ta gjejmë Zotin. Ai është këtu. Bëhu i sinqertë. Problemi është si ta heqim qafe!»

A ka të drejtë Adami? Zoti është këtu. Ne mund ta gjejmë atë. Por ne nuk e dëshirojmë këtë. Kur mendoj për mendimin e njerëzimit në të kaluarën, shoh se në 300 vjetët e fundit kemi bërë çmos për t'u liruar nga Zoti. Por këtë nuk e kemi arritur. Ne, në të vërtetë, të gjithë besojmë se Zoti ekziston, por nuk duam t'i mbështesim shpresat në të. Ne bëjmë ashtu siç bëjnë të tjerët: nuk merremi me këtë çështje. Nuk e mohojmë ekzistencën e Zotit, por nuk e vrasim mendjen për të. Nuk bëhemi armiq të tij, por as

miq jo. Kështu, problemi më i madh në jetë mbetet i pazgjidhur.

Një mjek zviceran shkruan në një libër se njeriu, i cili nuk e zgjidh problemin më të rëndësishëm jetësor, do të ketë vuajtje të mëdha emocionale dhe shpirtërore. Ai vazhdon: «Ne perëndimorët vuajmë nga mungesa e Zotit. Ne nuk e mohojmë atë, por as nuk i takojmë atij. Nuk duam të kemi asgjë me të dhe kjo është arsyeja pse vuajmë nga mungesa e tij». Edhe unë pajtohem me mendimin e tij.

Gati kudo dëgjoj njerëzit duke thënë: «Njeriu modern nuk interesohet për Zotin». Atyre mund t'u them këtë: «Njeriu modern i ka punët keq. Edhe unë jam njeri modern, por unë interesohem për Zotin. Nuk besoj se jam i prapambetur për shkak të këtij qëndrimi. Është shumë tronditës fakti se njeriu modern nuk e merr seriozisht çështjen e shpëtimit».

Do të përdor edhe një ilustrim të thjeshtë. Përfytyrojeni një nxënës që mëson të bëhet gjellëbërës. Një ditë gjellëbërësi kryesor thotë: «Ky nuk interesohet aspak për gjellëtari!» - «Po për çka interesohet?», e pyes. «Për pop muzikë dhe për vajza», përgjigjet shefi. «Duhet të ulni

veten në nivelin e tij», i them, «dhe tani e tutje folni me të vetëm për muzikën dhe për vajzat». - «Joo, joo!» përgjigjet shefi. «Nëse djaloshi nuk interesohet për gjellëtari, atëherë ka gabuar profesionin!»

A më kuptoni se ç'dua të them? Ne jemi të thirrur të bëhemi fëmijë të Perëndisë. Kur njeriu modern nuk interesohet për këtë, atëherë ai ka gabuar profesionin e tij si njeri. Nën rrethana të tilla është e kotë të flasësh me të, qoftë për gjëra të mundshme ose të pamundshme, të cilat eventualisht mund t'i interesojnë. Ajo që duhet të kuptojë është: «Vetëm nëse bëhet fëmijë i Perëndisë, do të jetë njeri i vërtetë».

### **3. PËRGJIGJJA E PERËNDISË**

#### **NË PYETJET MË TË RËNDËSISHME**

Përsëris: ne nga natyra nuk jemi fëmijë të Perëndisë, por ne jemi në këtë botë me qëllim që të bëhemi fëmijë të Perëndisë. Atëherë, diçka duhet të ndodh me ne. Nuk po ju flas vetëm sa për të kaluar kohën, por dua që t'ju ndihmoj atyre që kërkojnë qëllimin e jetës.

Pra, nëse nuk jemi fëmijë të Perëndisë, atëherë nuk e duam Perëndinë, nuk i mbajmë urdhërimet e tij, nuk çajmë kokën për të, nuk lutemi - përveç kur kemi ndonjë rast urgjent, atëherë na bie ndër mend. Prandaj gjëja më e rëndësishme për ne është të gjejmë përgjigje për pyetjen më thelbësore: «Si të bëhemi fëmijë të Perëndisë?» Tani do të kisha dashur t'ju jepja një copë letër dhe një laps dhe ju kisha thënë: «Shkruani, sipas mendimit tuaj, si mund të bëhet njeriu fëmijë i Perëndisë». Disa do të kishin shkruar: «Duke qenë njeri i mirë». Të tjerët: «Duke besuar në Zot». Por e gjithë kjo nuk mjafton. Pyetja: «Si të bëhem fëmijë i Perëndisë?» mbetet pa përgjigje.

Përgjigjen e kësaj pyetje më të rëndësishme mund ta marrim vetëm përmes zbulesës. Kjo do të thotë se vetë Zoti duhet të më tregojë se si të bëhem fëmijë i tij. Askush tjetër nuk mundet. Bibla jep një përgjigje të qartë. Ajo përgjigje është: vetëm përmes Jezusit! Miq të dashur, kur vij te Jezusi, atëherë zemra ime rrah më fort, puls i më shpejtohet, atëherë jam te qëllimi i jetës. Vertet, nëse dua të jem fëmijë i Perëndisë, këtë mund ta arrij vetëm përmes Jezusit.

Në Bibël është një varg që, kur përkthehet fjalë për fjalë, tingëllon kështu: «Jezusi ka ardhur nga bota e Perëndisë në këtë botë». Sot dëgjojmë vazhdimisht njerëz duke thënë se Bibla përmban pikëpamje të vjetëruara mbi jetën: Qielli lart, toka poshtë. Kjo është marrëzi! Në Bibël nuk ka gjëra të tilla. Bibla na tregon gjëra të rëndësishme për Zotin dhe për veten tonë. Ajo na tregon se Zoti është i pranishëm kudo. Po të fshihesh qoftë edhe në thellësitë e tokës, Zoti do të ishte atje. Bibla ka atë që ne në gjuhën moderne e quajmë pikëpamje shumëdimensionale mbi botën. Ne jetojmë në një botë tridimensionale ku ka gjatësi, lartësi dhe gjerësi. Mirëpo, ka edhe dimensione të tjera. Dhe, Zoti i takon një dimension tjetër. Ai është shumë afër, sa të mund të arrihet me dorë. Ai ecën me ne. Ai na sheh edhe kur ne nuk ecim në rrugën e tij. Por ne nuk mund ta kalojmë pengesën që na ndan nga dimension tjetër. Vetëm Zoti mund ta bëjë këtë. Ai e ka bërë këtë dhe ka ardhur te ne në personin e Jezusit

Besëlidhja e Re thotë kështu për Jezusin: «Erdhi te të vetët», - dhe në të vërtetë edhe vetë

bota është e tij - «por të vetët nuk e pranuan». Kjo është historia e Ungjillit deri në ditët tona. Jezusi erdhi, por njeriu ia mbylli derën. «Ai erdhi te të vetët, por të vetët nuk e pranuan». Ky duhej të ishte fundi i marrëdhënieve ndërmjet Zotit dhe njeriut. Mirëpo, për çudi, tregimi nuk merr fund këtu. Vargu tjetër vazhdon kështu: «Atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë». Duke e pranuar Jezusin bëhemi bij të Perëndisë. A e keni hapur ende derën e jetës suaj që ta pranoni Jezusin? «Atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë».

Gjatë Luftës së Parë Botërore kam qenë oficer i ri dhe kam jetuar larg prej Zotit. Megjithatë, pikërisht në këtë periudhë të jetës sime i hapa Jezusit derën e zemrës sime dhe e lejova të hynte. Kjo përvojë ma ka ndryshuar tërë jetën. Për ta ndjekur Jezusin kam kaluar nëpër shumë vështirësi. Kam qenë në burg. Shpesh kam qenë në rrezik. Mirëpo, asnjëherë nuk jam penduar dhe po të më jepej mundësia të jetoja edhe 100 herë, nga çasti që do të filloja të mendoja me kokën time, do të isha ndalur të vargu: «Atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin

të bëhen bij të Perëndisë». Vetëm kur të bëhem bir i Perëndisë, jeta ime ka kuptim. Pa marrë parasysh kush jam: pastor apo pastrues rrugësh, drejtor apo bravapunues, amvise apo mësuese, jeta ime fiton kuptim vetëm nga çasti kur bëhem fëmijë i Perëndisë. Pra, duhet ta pranoni Jezusin. Atëherë do ta gjeni kuptimin e jetës. Vetëm atëherë.

Është shumë interesant t'i studiosh personat e Besëlidhjes së Re. Ta marrim, për shëmbull, Maria Magdalenen. Jeta e saj nuk kishte kurrfarë kuptimi. Thuhet se ka qenë e pushtuar nga shtatë demonë. (Unë njoh njerëz, të cilët janë të pushtuar nga më shumë demonë.) Ajo duhet të ketë pasur një jetë të tmerrshme: jetë robërie. E shkreta duhet të ketë vuajtur shumë duke bërë një jetë të tillë të pakuptim. Pastaj në jetën e saj hyn Jezusi, Shpëtimtari, Biri i Hyjit, dhe dëbon demonët prej saj. Ai mund ta bëjë këtë dhe e bëri. Nga ai çast kjo grua i takonte Jezusit. Jeta e saj nuk është më pa kuptim. Më vonë ajo përjeton kryqëzimin dhe vdekjen e Jezusit. Atë ditë e kaploi një frikë e papritur: «Përsëri fillon jeta e saj e mëparshme, pa kuptim». Në mëngjesin e

ditës së tretë pas kryqëzimit, ajo bie në gjunjë duke qarë pranë varrit të Jezusit. Ajo kishte ardhur te varri dhe kishte parë se varri ishte i zbrazët. Guri i madh, që mbyllte hyrjen e varrit, ishte i rrokullisur dhe trupi i Jezusit nuk ishte aty. Prandaj ajo qante.

Unë mund ta kuptoj mirë këtë grua. Nëse unë do ta humbisja sot Jezusin, kjo do të më kishte çuar në humnerën e një jete të pakuptim. Vërtet, e kuptoj atë: «Shpëtimtarin nuk e kam. Jeta ime nuk ka më kuptim».

Pastaj, papritmas, ajo dëgjoi një zë prapa saj: «Mari!» Ajo u kthye dhe e pa Jezusin e ringjallur. Lotët e dëshpërimit që i rridhnin nëpër faqe iu kthyen në lot gëzimi. Me një gëzim të madh ajo thirri: «Rabbuni!» që do të thotë Mësues.

Shëmbulli i kësaj gruaje tregon qartë se nuk kemi nevojë për ndonjë filozofi të madhe për të marrë përgjigje në pyetjen lidhur me kuptimin e jetës. Edhe njeriu më i pashkolluar e ka të qartë: «Jeta ime është e pakuptim. Pse jetoj?» Atë çast kur Maria Magdalena e ka pranuar Jezusin në jetën e saj, ajo e ka zgjidhur çështjen e kuptimit të jetës së vet - është bërë fëmijë i Zotit të gjallë dhe në jetën e saj ka hyrë drita.



Prandaj po ju lus: pranojeni Jezusin! Ai ju pret. Ai është shumë afër jush. Filloni të bisedoni me të. Do të ishte gjë e madhërishme po t'i thoshit: «Zoti Jezus, jeta ime nuk ka kuptim. Eja tek unë!»

Kur e pranojmë Jezusin, një revolucion i vërtetë fillon në jetën tonë. Ne bëhemi pjesëtarë të vdekjes dhe të ringjalljes së tij. Fillojmë një jetë plotësisht të re si fëmijë të Perëndisë. Ai na jep Shpirtin e vet, i cili na i ndryshon dëshirat dhe mendimet tona.

Të jesh fëmijë i Perëndisë nuk është vetëm një ndryshim i jetës, por është një jetë krejtësisht e re. Pranojeni Jezusin dhe do t'i përjetoni të gjitha këto.

Në shekullin e kaluar ka jetuar në Westfalia një këpucëtar me emër Rahlenbeck. Njerëzit e quanin «prifti pietist» për shkak të dëshirës së madhe që kishte për ta ndjekur Jezusin. Ai kishte aftësi të mëdha shpirtërore dhe ishte një njeri i bekuar. Një ditë i erdhi për vizitë një prift i ri. «Zotëri», i tha Rahlenbecku, «studimet tuaja teologjike nuk garantojnë që ju jeni i shpëtuar. Duhet ta pranoni Jezusin!» Prifti iu përgjigj: «Unë e kam Jezusin. Pikturën e tij e kam të

varur në murin e dhomës sime të punës». Rahlenbecku plak ia ktheu: «Jezusi në mur është i qetë dhe i heshtur. Por, nëse e pranoni Jezusin në zemrën dhe në jetën tuaj, do të ketë shumë zhurmë!»

Dëshiroj që edhe ju ta përjetoni këtë zhurmë në jetën tuaj! Dëshiroj që edhe ju t'i jepni fund jetës suaj mëkatare dhe ta lavdëroni Atin tuaj qiellor, që ju ka bërë fëmijë të tij, që i ka dhënë kuptim jetës suaj, që ju ka mundësuar që tani e tutje ta nderoni atë me mendime, me fjalë dhe me vepra.

Kuptojeni këtë që po ju them sepse nuk është ndonjë marrëzi fetare ose mendime të ndonjë prifti, por fjala është për jetën e përjetshme dhe për vdekjen e përjetshme.

Zoti Jezus thotë: «Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe e hap derën, unë do të hyj tek ai». Po këtë gjë ju thotë Zoti Jezus edhe ju: «Ja, unë qëndroj te dera e jetës suaj. Hapne derën! Unë do t'i jap kuptim jetës suaj».

Njëherë erdhi tek unë një minator i vjetër dhe më tha: «Zotëri pastor, dua të flas me ju. Ishte 70 vjeçar. Filloi të më tregojë: «Kur kam

qenë 17 vjeç, kam marrë pjesë në një ungjillëzim. Aty pata ndier se Jezusi trokiste në derën time. Por, unë thashë me vete: 'Nëse e marrë seriozisht këtë dhe e pranoj Jezusin, atëherë do të më qeshin të gjithë shokët. Jo, nuk mund ta bëj këtë'. Pastaj u largova». Ai vazhdoi: «Tani po i afrohet fundi jetës sime. Jam plakur. Tani po e kuptoj se jeta ime ka qenë një deshtim sepse në atë rast nuk ia kam hapur derën Jezusit».

Miq të dashur, ne kemi vetëm një jetë të vetme dhe për këtë arsye pyetja «pse jetoj?» është me rëndësi jetike. Perëndia ka dhënë përgjigje të qartë për këtë pyetje. Përgjigjja është në Jezusin e kryqëzuar dhe të ringjallur.

Jezusi edhe tani po qëndron te dera juaj dhe po troket. Hapjani derën! Kurrë nuk do t'ju vijë keq!



